

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJU

Nr.faq/Bt.str. 327
Datë/Datum. 06.03.2019
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 06.03.2019

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 16, nenin 17, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, Vendimin e Kuvendit të Komunës Nr. 217, të datës 20.11.2018, bën këtë:

**NJOFTIM
PËR PJESËMARRJE NË DISKUTIM PUBLIK PËR PLOTËSIM-
NDRYSHIMIN E STATUTIT TË QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË
FAMILJARE DR. FATMIR KRASNIQI NË FUSHË-KOSOVË**

Njoftohen qytetarët, personeli shëndetësorë dhe të gjithë të interesuarit e tjerë, se diskutimi publik për: 'Plotësim-ndryshimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare Dr. Fatmir Krasniqi në Fushë-Kosovë', është i hapur nga data: 06.03.2019-19.03.2019.

Për sqarime dhe konsultime lidhur me 'Plotësim-ndryshimin e Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare Dr. Fatmir Krasniqi në Fushë-Kosovë', mund të drejtoheni në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, kati i parë, në ndërtesën e Komunës së Fushë-Kosovës, rruga 'Tahir Zemaj'.

Takimi për konsultim publik do të mbahet më datë: **18.03.2019, në orën 10:00h**, në sallën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, në ndërtesën e Komunës.

Njoftimi për diskutim publik publikohet në ueb-faqen e Komunës së Fushë-Kosovës.

Përshëndetje!




 REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPSTINA KOSOVO-POLJE
 DREJTORIA E ADMINISTRATIVES - DIREKTORATI ADMINISTRACIJE

Nr.faq/Re.shk. 915
 Datë/Datum. 22.10.2018
 KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPSTINA KOSOVO-POLJE




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA
 KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPSTINA KOSOVO-POLJE
 MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Datë:	22.10.2018
Për:	Kuvendin e Komunës
Përmes:	Z.Burim Berisha, Kryetar i Komunës,
Nga:	Jakup Dumani-, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
Lënda:	Propozim për plotësimin e Statutit të QKMF-së !



Këshilli Drejtues i QKMF-së "Dr.Fatmir Krasniqi" në takimin e mbajtur të datë 22.08.2018 ka propozuar që të bëhet plotësimi i Statutit të QKMF-së .

Në bazë të kësaj propozohet që neni 9 të plotësohet duke iu shtuar pika :

1.1.7 Sektori Konsultativ ;

1.17.1 Pediatria;

1.17.2 Gjinekologjia

Arsyetim: Aktualisht në QKMF "Dr.Fatmir Krasniqi" , në cilësinë e konsulantit punojnë padiatri dhe gjinekologu të cilët në Statutin ekzistues nuk janë përfshirë në kuadër të asnjë njësie.

Ky ka qen një lëshim gjatë hartimit të draftit përfundimtar të Statutit , dhe për këtë arsye propozojm ;

Kuvendin e Komunës që të lejoj plotësimi i Statutit të QKMF-së "Dr.Fatmir Krasniqi" në Fushë –Kosovë.

Ndryshimi i statutit të QKMF-së do të inkorporohet në versionin përfundimtar të Statutit me ndryshimet e propozuara në nenin 9.

Faleminderit !

Neni 8 Përfaqësimi

1. QKMF-ja "Dr. Fatmir Krasniqi" në Fushë-Kosovë është institucion, i cili bën pjesë në rrjetin e institucioneve të Kujdesit Parësor shëndetësorë, publik të Ministrisë së Shëndetësisë.
2. QKMF-ja "Dr. Fatmir Krasniqi" kryen dhe ofron shërbime të kujdesit parësor për qytetarët e komunës, sipas dispozitave ligjore që janë në fuqi.
3. Për nënshkrimin e kontratave, më të cilat fitohen, tjetërsohen apo shiten objektet dhe pajisjet kapitale, me ose pa vlerë rigjeneruese të QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi", duhet të ketë së pari propozimin e menaxhmentit të QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi" dhe aprovimin e themeluesit, në bazë të ligjeve në fuqi.
4. Drejtori i QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi" ka të gjitha autorizimet për përfaqësimin juridik dhe afarist, brenda veprimtarisë së QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi" me pëlqim të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

IV. Struktura e Institucionit dhe Sistemi i Informimit në QKMF

Neni 9 Organizimi i QKMF

1. QKMF "Dr. Fatmir Krasniqi" me qëllim të ofrimit të perkujdesjes shëndetësore për banorët e vet, organizohet me këto njësi përbërëse:
 - 1.1 Departamenti i Mjekësisë Familjare me këtë përbërje:
 - 1.1.1 Sektori i Mjekësisë Familjare;
 - 1.1.2 Njësia e SISH;
 - 1.1.3 Njësia e Vaksinimit dhe Imunizimit;
 - 1.1.4 Sektori i Shëndetit Oral Preventiv;
 - 1.1.5 Sektori i Kujdesit Urgjent;
 - 1.1.6 Sektori i Diagnostikës;
 - 1.1.6.1 Kabineti Radiologjik;
 - 1.1.6.2 Laboratori,
 2. Departamenti i Administratës së QKMF "Dr. Fatmir Krasniqi" Fushë-Kosovë organizohet në:
 - 2.1. *Njësia ose Zyra e personelit,*
 - 2.2. *Njësia ose Zyra Juridike,*
 - 2.3. *Njësia ose Zyra për buxhet dhe financa,*
 - 2.4. *Njësia ose Zyra për shërbime teknike*
 3. Barnatorja Qendrore;
 - 3.1 Barnatorja është njësi organizative e QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi", e cila themelohet dhe funksionon sipas ligjeve dhe akteve nën ligjore që rregullojnë veprimtarinë farmaceutike;
 - 3.2 Në barnatore e QKMF-së "Dr. Fatmir Krasniqi" mund të shpërndahen vetëm barnat nga Lista Esenciale e Barnave, e lejuar nga Ministria, dhe të përshkruara në recetat unike, nga Mjekët e Sektorit të Mjekësisë Familjare.